



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 1628/4 prot., datë 06/4/2012

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 1287/4 prot., datë 2/4/2012

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1004/12 prot., datë 13/04/2012

URDHËR I PËRBASHKËT

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR KRIJIMIN E FORMATIT TË STANDARDIZUAR PËR SISTEMIN E KONSOLIDUAR TË TË DHËNAVE PËR VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT DHE PËR KRIJIMIN E FORMATIT TË STANDARDIZUAR PËR SISTEMIN E KONSOLIDUAR TË TË DHËNAVE PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIMIN E ORGANIZUAR

Në mbështetje të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Ngritjen e grupit të punës për krijimin e formatit të standardizuar për sistemin e konsoliduar të të dhënave për veprat penale të korrupsionit dhe për krijimin e formatit të standardizuar për sistemin e konsoliduar të të dhënave për veprat penale që lidhen me krimin e organizuar, në përmbushje të objektivave të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Evropian.
2. Grupi i punës drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe përbëhet nga:
 - 2 përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë;
 - 3 përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe

- 2 përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Grupi i punës ka në përbërje ekspertë të nivelit teknik dhe specialistë të teknologjisë së informacionit që mbulojnë çështjet e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore.

4. Grupi i punës ngarkohet të hartojë formatin e standardizuar të sigurimit të të dhënave fillestare, historikut mbi rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale dhe/ose në gjykatë me vendim të formës së prerë, si dhe të përcaktojë metodologjinë e mbledhjes së tyre.

5. Grupi i punës asistohet nga ekspertë të Projektit PACA, Misionit Euralius III dhe Misionit PAMECA.

6. Grupi i punës paraqet tabelën e parë në lidhje me çështje konkrete të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të hetuara dhe të ndjekura deri në dhënien e vendimit gjyqësor brenda një muaji nga hyrja në fuqi e tij.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare elektronike të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij.

MINISTRI I DREJTËSISË

Eduard HALIMI

(nënshkrimi)



MINISTRI I BRENDSHËM

Bujar NISHANI

(nënshkrimi)



PROKURORRI PËRGJITHSHËM

Ilda RAMA

(nënshkrimi)

